

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6366  
E shtunë, 17 korrik 2021  
çmimi 0.40 €

## Dështon në Kuvend miratimi i marrëveshjes ndërkombëtare



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## PARTIA SOCIALDEMOKRATE, AKSION KUNDËR TAKSËS SË RE PËR REGJISTRIM TË AUTOMJETEVE

# PUSHTETI I LV-së ARRESTON ISH-SHOKËT E KURTIT

Partia Socialdemokrate ka zhvilluar të premten një aksion me qëllim të kundërshtimit të vendosjes së një takse të re prej 5 eurosh për makinat e regjistruara. Teksa aktivistët e kësaj partie kanë vendosur nëpër veturat zyrtare grafite me mbishkrimin "Zhvatës", ka ndërhyrë policia duke i arrestuar tetë aktivistë të cilët pastaj janë liruar. Mënyra e arrestimit të tyre është cilësuar e dhunshme, duke nxitur reagime të shumta në shoqëri. Ish-aktivistët e LV-së kanë vlerësuar se pushteti i ri po i arreston ish-shokët e kryeministrit dhe ministrit të Brendshëm me të cilët dikur rrokullisnin xhipat e EULEX-it dhe bënin aksione të ngjashme



## AKTUALE



### MBI 100 TË VDEKUR NGA PËRMBYTJET NË GJERMANI

F. 2

### IKSHPK-ja: UJI NË DRENOC TË DEÇANIT ËSHTË I PAPIJSHËM

F. 7

### MË 20 KORRIK, DITA E PARË E KURBAN BAJRAMIT

F. 7



## EKONOMI

### KEDS-i DO T'I TRAJTOJË ME PRIORITET KËRKESAT PËR LIDHJE TË RE NGA DIASPORA

F. 8

### NDRYSHIMET PËR LIGJIN PËR AUTOMJETE KALOJNË EDHE NË KOMISIONIN PËR LEGJISLACION

F. 8



## SPORT

### BATATINA: LLAPI U ELIMINUA ME KOKËN LART

F. 12

Komuna e Prishtinës  
Opština Prishtina  
Municipality of Prishtina



### PREMTOI 100 PROJEKTE, SHPEND AHMETI REALIZOI VETËM 28 SOSH

## BIDENI DHE MERKELI BASHKË KUNDËR AGRESIONIT RUS



**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht--Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.PK.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Bideni dhe Merkeli, bashkë kundër agresionit rus

UASHINGTON, 16 KORRIK - Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Gjermania do të qëndrojnë së bashku kundër agresionit rus ka thënë presidenti amerikan Joe Biden gjatë takimit me kancelaren gjermane, Angela Merkel, në Uashington. Bideni ka thënë se ka shprehur shqetësimet e tij te Merkeli për një tubacion gazi midis Rusisë dhe Gjermanisë, por ata u pajtuan që Moska të mos lejohet ta përdorë energjinë si armë. Merkeli, e cila ka punuar me katër presidentë amerikanë, do të largohet nga detyra në vjeshtë. “Ne qëndrojmë së bashku dhe do të vazhdojmë të qëndrojmë së bashku për t’i mbrojtur aleatët tanë të Lindjes në NATO kundër agresionit rus”, ka thënë Bideni në konferencën

e përbashkët për media me Merkelin. Ai ka pranuar se nuk pajtohet me Merkelin rreth tubacionit të gazit Rrjedha e Veriut 2, i cili ka vlerën e gati 11 miliardë dollarëve dhe është në prag të përfundimit. Uashingtoni e ka kundërshtuar vazhdimisht tubacionin për shkak të shqetësimeve se mund të përbëjë kërcënim për sigurinë energjetike evropiane dhe se mund ta privojë Ukrainën nga tarifat e tranzitit, që mbledh nga tubacionet që kalojnë në territorin e saj. “Miqhtë e mirë mund të mos pajtohen”, ka deklaruar Bideni. Merkeli ka përsëritur qëndrimin e saj se Rrjedha e Veriut 2 “nuk është projekt për të zëvendësuar ndonjë lloj tranziti përmes Ukrainës”.



## Mbi 100 të vdekur nga përmbytjet në Gjermani



BERLIN, 16 KORRIK - Numri i të vdekurve nga përmbytjet në pjesën perëndimore të Gjermanisë u rrit në 103. Gjashtëdhjetë viktima u raportuan në landin Rajnland Falc dhe 43 në landin fqinj, Nordrajn Vesthalen. Autoritetet paralajmërojnë se numri i viktimave mund të rritet ende. Ekipet e shpëtimit janë duke vazhduar kërkimet për qindra njerëz të tjerë të zhdukur. “Kam frikë se shkallën e plotë të katastrofës do ta shohim në ditët në vijim”, ka thënë kancelarja gjermane Angela Merkel, nga Uashingtoni, ku qëndroi për vizitë zyrtare. Merkeli premtoi mbështetje të plotë për të prekurit, duke thënë



se qeveria e saj nuk do ta lërë vetëm popullin “në këtë kohë të vështirë dhe të tmerrshme”. Presidenti i Gjermanisë, Frank-Walter Steinmeier, ka thënë se

do të udhëtojë në zonat e goditura. Steinmeier e lidhi motin ekstrem me ngrohjen globale dhe tha se duhet të bëhet më shumë për mjedisin. Rreth


15 000 policë, ushtarë dhe punonjës të shërbimit të urgjencës, janë duke marrë pjesë në operacionet e kërkim-shpëtimit. Helikopterët kanë nxjerrë banorët e bllokuar nga majat e çatave, ndërsa tanket po pastrojnë rrugët nga pemët dhe mbeturinat e rena. Belgjika dhe Holanda janë goditur gjithashtu keq nga përmbytjet, ndërsa vërshime ka edhe në Luksemburg dhe Zvicër. Autoritetet belge kanë raportuar për së paku 14 persona të vdekur. Në Belgjikë pamjet dramatike të përmbytjeve treguan makina që merrte uji përgjatë një rruge në qytetin Vervi.

## ShBA-ja ofron 10 milionë dollarë shpërblim në luftën kundër hakerëve

Uashington, 16 korrik - Shtetet e Bashkuara thanë se ofrojnë 10 milionë dollarë shpërblim për informacionet që çojnë në identifikimin e kriminelëve kibernetikë. Zotimi vjen pas një sërë sulmesh kibernetike në ShBA, që besohet se janë kryer nga hakerë me bazë në Rusi. Departamenti Amerikan i Shtetit tha se do të paguante 10 milionë dollarë për këdo që mund të identifikojë ose lokalizojë një person, që sulmon infrastrukturën kritike të ShBA-së, “derisa vepron nën drejtimin ose nën kontrollin e një qeverie të

huaj”. Zyrtarët amerikanë kanë thënë se shumë prej sulmeve të fundit kibernetike e kanë origjinën në Rusi, por lidhja midis kriminelëve kibernetikë dhe qeverisë ruse nuk është vendosur. Rusia e mohon përgjegjësinë. Qindra kompani amerikane janë prekur nga një sulm kibernetik, që është kryer më 2 korrik, kundër kompanisë së teknologjisë Kaseya, me seli në Floridë. Në maj, hakerët kanë sulmuar operatorin më të madh të tubacionit të karburanteve në

ShBA, Colonial Pipeline, ndërsa në qershor shënjestër e sulmit kibernetik ka qenë kompania më e madhe në botë për përpunimin e mishit, JBS. Presidenti amerikan, Joe Biden, ka biseduar me homologun rus Vladimir Putin për sigurinë kibernetike gjatë takimit të tyre në Gjenevë muajin e kaluar dhe gjatë një bisede telefonike javën e kaluar. Bideni është zotuar se “do të ndërmarrë çdo veprim të nevojshëm” për t’i ndaluar sulmet kibernetike nga Rusia, ka thënë Shtëpia e Bardhë.





# Premtoi 100 projekte, Shpend Ahmeti realizoi vetëm 28 sosh

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

**PRISHTINË 16 KORRIK** - Iniciativa për Progres INPO ka mbajtur të premten konferencë për media, në të cilën ka paraqitur raportin me titull "100 premtimet e Shpend Ahmetit". Në këtë raport u paraqitën gjetjet lidhur me përbushjen e 100 premtimeve të kryetarit të komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti.

Raporti ka pasqyruar të dhënat lidhur me atë se sa nga premtimet janë përbushur plotësisht, sa janë gjysmë të përbushura, sa kanë filluar të realizohen dhe për sa premtime nuk është bërë asnjë veprim në kuadër të realizimit. Sipas këtij raporti, kryetari i komunës së Prishtinës gjatë fushatës zgjedhore të vitit 2017 ka premtuar gjithsej njëqind (100) premtime të cilat i ka ndarë në dhjetë fusha: 1. Lagjja jonë e pastër dhe me rregull e rend. 2. Lagjja jonë me sport dhe rekreacion. 3. Mobilitet dhe parkingje edhe në lagjen tonë. 4. Prona jonë e barabartë në planifikim. 5. Shëndet dhe mirëqenie sociale për të gjithë. 6. Lagjja jonë me arsim të mirëfilltë. 7. Zhvillim në çdo cep. 8. Art në lagjen tonë. 9. Infrastrukturë në çdo lagje. 10. Ndërmarrjet publike në shërbim të qytetarëve. Sipas INPO-s, secila fushë përmban në vete premtime të veçanta dhe numri i përgjithshëm i tyre është njëqind (100).

Hulumtuesi i lartë i INPO-s, Qëndrim Arifi, gjatë kësaj

konferencë ka theksuar se nga njëqind (100) premtime, për gati katër vjet mandat janë përbushur plotësisht vetëm njëzet e tetë (28) premtime. "Gjysmë të përbushura janë pesëmbëdhjetë premtime, kanë filluar së realizuari tridhjet e katër premtime, kurse nuk është ndërmarrë asnjë veprim konkret në kuadër të realizimit të njëzetë e tre premtimeve", ka thënë ai.

Arifi ka shtuar se fusha me më së paku premtime të realizuara është fusha "Prona jonë e barabartë në planifikim", "ku nga katërmbëdhjetë premtime, plotësisht nuk është realizuar asnjë, ndërsa fusha me më së shumti realizim është fusha 'Ndërmarrjet publike në shërbim të qytetarëve', ku nga dhjetë premtime, tetë prej tyre janë realizuar plotësisht. Më shumë se gjysma e premtimeve, përkatësisht 57 për qind prej tyre, janë në fazat fillestare të implementimit, përkatësisht nuk kanë filluar fare të realizohen", ka deklaruar Arifi.

Monitoruesi i INPO-s, Diell Haxhimusa, ka potencuar se duke marrë parasysh nivelin e përbushjes së premtimeve, kryetari i komunës së Prishtinës duhet t'i shtojë angazhimet në kuadër të realizimit të premtimeve të dhëna gjatë fushatës zgjedhore të vitit 2017, ku si pasojë edhe është fituar mandati katërveçar. Ai ka thënë se Ahmeti duhet të koordinojë dhe shpërndajë përgjegjësitë për secilin drejtor komunal, respektivisht t'i vë në



përgjegjësi drejtorët e drejtorive në të cilat bëjnë pjesë premtimet e papërbushura.

Haxhimusa ka theksuar se Ahmeti duhet të kujdeset që

premtimet e filluara apo të mbetura në gjysmë të përfundohen sipas afateve të paracaktuara edhe pas organizimit të zgjedhjeve lokale,

përkatësisht të shfrytëzohen të gjithë mekanizmat që premtimet e filluara apo ato gjysmë të përfunduara në të ardhmen të përbushen plotësisht.

## S'ka rrezik për përmbytje në Kosovë



**PRISHTINË, 16 KORRIK (ER)** - Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK) ka njoftuar se, pavarësisht prej reshjeve me intensitet të lartë, nuk do të ketë rrezik për përmbytje lumore në vendin tonë. Sipas IHMK-së, reshje të shiut do të ketë nga 17 deri më 19 korrik. "E shtunë, 17 korrik 2021, e hënë, 19 korrik 2021, 00:00. Sipas llogaritjeve të IHMK-së (sektori për hidrologji dhe prognoza hidrologjike), nga data 17-19 korrik 2021, pasi që pritet të ketë reshje të shiut me intervale të ndryshuara të cilat do të jenë të intensitetit të ulët deri mesatarisht të lartë, por kryesisht të karakterit lokal, mund të jenë të shoqëruara me shtrëngata dhe herë pas here me shkarkime rufesh dhe mundësi breshëri, të

cilat mund të shkaktojnë probleme dhe vështirësi lokale si në funksionimin e sistemeve të kanalizimeve dhe të ujërave atmosferike, vështirësi lokale të qarkullimit rrugor, rrëshqitje të dheut etj", ka njoftuar IHMK-ja. Ky institut ka njoftuar se reshjet me intensitet më lartë në disa zona mund të aktivizojnë rrjedhat e shpjeta me karakter malor siç janë përrrenjtë dhe paraqitjen e vërshimeve të shpejta lokale. "Në lumenjtë kryesorë, sipas rrjetit të stacioneve hidrometrike në Kosovë, nuk parashihet që të kenë lëkundje të theksuara të niveleve dhe prurjeve të ujit, prandaj edhe nuk do të ketë rrezik nga përmbytjet lumore", ka njoftuar IHMK-ja.

## Shefi i BE-së në Kosovë takohet me Krasniqin, bisedojnë për reformën zgjedhore

Prishtinë, 16 korrik (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka pritur të premten në takim shefin e Zyrës së Bashkimit Evropian (BE) në

Kosovë, Tomas Szunyog. Në këtë takim Szunyogu e ka uruar Krasniqin për zgjedhjen e tij në krye të PDK-së. Po ashtu, Szunyogu ka bërë me dije se me Krasniqin kanë diskutuar për

nevojën e reformës zgjedhore. "Urova kryetarin e ri të PDK-së, Memli Krasniqi, për pozitën e tij të re. Diskutova me të për përgatitjet për zgjedhje lokale dhe për nevojën e reformës

zgjedhore. Ramë dakord për përpjekjet e përbashkëta për avancimin e Kosovës në agjendën e saj të integritimit evropian", ka shkruar Szunyog në llogarinë e vet në "Twitter".







PARTIA SOCIALDEMOKRATE, AKSION KUNDËR TAKSËS SË RE PËR REGJISTRIM TË AUTOMJETEVE

# Pushteti i LV-së arreston ish-shokët e Kurtit

Partia Socialdemokrate ka zhvilluar të premtën një aksion me qëllim të kundërshtimit të vendosjes së një takse të re prej 5 eurosh për makinat e regjistruara. Teksa aktivistët e kësaj partie kanë vendosur nëpër veturat zyrtare grafitë me mbishkrimin “Zhvatës”, ka ndërhyrë policia duke i arrestuar tetë aktivistë, të cilët pastaj janë liruar. Mënyra e arrestimit të tyre është cilësuar e dhunshme, duke nxitur reagime të shumta në shoqëri. Ish-aktivistët e LV-së kanë vlerësuar se pushteti i ri po i arreston ish-shokët e kryeministrit dhe ministrit të brendshëm me të cilët dikur rrokullisnin xhipat e EULEX-it dhe bënin aksione të ngjashme

**EPOKA E RE**

**Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 16 KORRIK** - Aksioni i Partisë Socialdemokrate, për ta kundërshtuar taksën prej 5 eurosh për regjistrimin e veturave, ka përfunduar me arrestimin e tetë aktivistëve të kësaj partie nga Policia e Kosovës. PSD-ja aksionin e ka zhvilluar në rrugën “Ukshin Hoti”, tek ish-ndërtesa e “Rilindjes”, ku ka vënë grafitë dhe tiketa në vetura zyrtare me mbishkrimin “zhvatës”.

Me pretekstin se në këtë aksion janë dëmtuar veturat zyrtare, Policia e Kosovës ka ndërhyrë duke e arrestuar kryetarin e PSD-së, Dardan Molliqaj dhe disa aktivistë të tjerë. Pas disa orëve, Dardan Molliqaj, Teutë Rrusta, Nol Nushi, Zgjim Hyseni, Qëndrim Sahiti, Frashër Krasniqi, Ali Krasniqi dhe Korab Korça janë

liruar.

PSD-ja aksionin e policisë e ka vlerësuar të dhunshëm, duke treguar se gjatë arrestimit janë lënduar aktivistët e saj. “Gjatë aksionit të sotëm, për ta shfaqur zhvatjen që pushteti i Kurtit po e bën ndaj qytetarëve, duke taksuar shtesë regjistrimin e makinës e duke krijuar monopol për një kompani, policia ndërhyri dhunshëm për ta ndërprerë aksionin dhe arrestoi e lëndoi brutalisht aktiviste e aktivistë të PSD-së. Policia, nën urdhrat e Kurtit, me përdorim brutal të dhunës po dëshiron të shtypë këdo që kundërshton shefin e tyre. Zhvatja ndaj qytetarëve nuk guxon të kalojë heshtur e nën kërcënimin e dhunshëm e brutal të pushtetit”, është thënë në reagimin e PSD-së.

Mënyra e arrestimit të aktivistëve të PSD-së ka nxitur reagime të shumta në shoqëri.

Ish-deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje dhe Partisë Socialdemokrate (PSD), Shqipe Pantina, ka kritikuar ashpër ministrin e Punëve të Brendshme (MPB), Xhelal Sveçla, duke thënë se ai ka arrestuar brutalisht shokët me të cilët dikur i

rrotullonte xhipat e EULEX-it. “Xhelal ministër kryepolici sot brutalisht arreston shokët me të cilët dikur i rrotullonte xhipat e EULEX-it. Nuk e paska pasur për shtet, por veç për pak pushtet! Marre!”, ka shkruar Pantina në llogarinë e vet në “Facebook”. Edhe shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Arben Gashi, ka kundërshtuar formën e arrestimit të aktivistëve të PSD-së. “Keq, shumë keq! Shokët e deridjeshëm të Albinit arrestohen në këtë formë me urdhër të Xhelal ministrit. Arrestohen për mendimet dhe aksionet e tyre politike”, ka shkruar Gashi në profilin e vet në “Facebook”.

## Tiketa e pabarazisë

Përmes aksionit të së premtës, PSD-ja ka kundërshtuar vendimin e qeverisë që qytetarët e Kosovës nga 1 shtatori të paguajnë nga 5 euro për çdo veturë që regjistrohet. Këto para do t’i marrë një kompani private. “Mbi 2 milionë euro në vit një kompanie private. Pa konkurrencë. Monopol. Çmim 5 fish më të shtrenjtë, 90 % e të cilit është fitim për kompaninë. Kompani me 3 punëtorë. Arsyetimi? Skandaloz. E paska nisur qeveria e kaluar. Pra këta qenkan vetëm vazhdimësi, jo ndryshim. Këtë na e tha Hysen Durmishi dje. Këtë po e thotë Albin Kurti përditë”, ka vlerësuar PSD-ja në një njoftim për media. Sipas PSD-së, në këtë mënyrë qeveria po u merr para të varfërve për t’u dhënë të pasurve. “Një qeveri projekti ekonomik e politik i së cilës është thjesht, formalizimi i ekonomisë dhe sundimi i ligjit, vjelja e taksave dhe vendosja e rendit, është qeveri që i merr shumicës (së varfër) për t’i dhënë pakicës (së pasur). Sepse ligji është bërë për të pasurit. Sepse atyre u intereson që pabarazia të jetë sa më e formalizuar. Jorastësisht edhe homologimi po





u hiqet vetëm të pasurve. Atyre që blejnë makina të reja. Jo edhe atyre që kanë më pak, e që përgjithësisht blejnë makina të përdorura”, është thënë në njoftimin e PSD-së.

Një ditë më parë zëvendësministri i Infrastrukturës, Hysen Durmishi, fajin për këtë çështje ia ka lënë qeverisë së kaluar. “Si procedurë ka qenë përmes

shprehjes së interesit, ku kanë aplikuar disa kompani dhe në fund nga komisioni vlerësues është zgjedhur kompania e përgjegjshme fituese. Kur ne kemi ardhur në qeveri e kemi gjetur marrëveshjen e gatshme. Vetëm duhej të nënshkruhej. Tre muaj nuk e kam nënshkruar këtë marrëveshje derisa jam siguruar se është gjithçka në përputhje me ligjin dhe procedurat dhe se

është interes i Kosovës. Kam autorizuar auditim të procesit dhe kam marrë opinionet nga Zyra Ligjore e kryeministrit dhe Zyra Ligjore e ministrisë. Të gjitha rekomandimet kanë qenë që duhet nënshkruar marrëveshja sepse, në të kundërtën, do të kemi dëme financiare si shtet, sepse kompania e fiton rastin në gjykatë. Unë e kam nënshkruar

këtë marrëveshje më 8 qershor 2021”, ka shkruar ai në profilin e vet në “Facebook”.

Ai ka bërë me dije se me këtë veprim Kosova i ka disa përfitime. “Tiketa ngjitëse ndikon në evidentimin e lehtë të automjeteve në komunikacion, prandaj do të mundësojë që shumë shpejt të arrijmë në pragun nën 5% të automjeteve të paregjistruara. Me këtë ne kemi

përfitim si qytetarë sepse në njërin anë hiqet taksa prej 30 eurosh, në anën tjetër plotësojmë kriterin kryesor të aplikimit për kartonin e gjelbër me të cilin përfitimet janë të shumta. Përfitim tjetër natyrisht që është edhe siguria rrugore sepse nuk do të kemi automjete pa kontroll teknike e regjistrim në komunikacion e rrjedhimisht më pak aksidente”, ka shkruar ai.



## Ministri Aliu: Ndërtimi i ‘Luginës së Diellit’ në veri është i paligjshëm

PRISHTINË, 16 KORRIK - Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në Kosovë, Liburn Aliu, ka thënë të premten se ndërtimi i vendbanimit “Lugina e Diellit” në komunën e Zveçanit në veri të Kosovës është i paligjshëm. Ky projekt financohet nga Serbia. “Ajo çka ka ndodhur në veri, aq sa kemi informacion, i bie që as me planet urbane të Serbisë nuk është... Pra, zhvillimi në Luginën e Diellit konsiderohet ndërtim pa leje sa iu përket institucioneve të Republikës së Kosovës, por nuk ka asnjë informacion që ekziston çfarëdo leje ndërtimore, respektivisht çfarëdo lloj plani hapësinor, që është respektuar për ndërtimin e tij. Prandaj, mund të themi se në tërësi është një veprim i jashtëligjshëm dhe në kundërshtim me çfarëdo ligji”, ka thënë Aliu gjatë seancës së Kuvendit të Kosovës.

Shteti i Serbisë dhe Kisha Ortodokse Serbe janë në përfundim të ndërtimit të lagjes “Lugina e Diellit”

në komunën e Zveçanit, e cila është e banuar me shumicë serbe.

Në një sipërfaqe prej 15 hektarësh tokë janë 300 njësi banesore të destinuara për personat e zhvendosur nga Kosova, të komunitetit serb, raporton REL. Është raportuar se projekti kap vlerën prej 14 milionë eurosh. Aliu ka thënë se në bazë të informacioneve që kanë, Ministria e Mjedisit e Kosovës ka dërguar në vitin 2016 inspektorët e saj për të kërkuar një raport nga Komuna e Zveçanit në lidhje me ndërtimin e vendbanimit.

Por, atëbotë, shtoi ai, askush nga ajo komunë nuk ka pranuar t’i japë përgjigje inspektoratit. Pas kësaj, Aliu ka theksuar se Ministria e Mjedisit ka ngritur padi kundërvajtëse ndaj drejtoreshës së urbanizmit në komunën e Zveçanit. “Pas kësaj padie, dy vjet më vonë, gjykata e ka shfuqizuar atë, për faktin se kanë kaluar dy vjet dhe padia është parashtruar. Tani në



dokumentacione, në aspektin gjyqësor, situata është krejtësisht e mbyllur sa i përket ministrisë karshi komunës së Zveçanit”, ka theksuar Aliu.

Aliu ka thënë se ministria që drejton ai ka 38 të punësuar në veri të Kosovës, ndërsa në kuadër të Inspektoratit të Ministrisë janë 12 punëtorë. “Por, fatkeqësisht, raporte për gjendjen në veri në mënyrë zyrtare nuk ka”, është

shprehur Aliu. Ai ka shtuar se Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës është duke punuar për t’i mbledhur të gjitha informatat për aktivitetet në veri të Kosovës dhe për punëtorët e kësaj ministrie në veri dhe se ajo do ta informojë Kuvendin dhe qeverinë më vonë. “Se cilat do të jenë veprimet politike më pastaj për vendosjen e rendit, mbetet çështje politike që do të

diskutohet këtu në Kuvend”, ka thënë Aliu.

Marrëveshja për ndërtimin e vendbanimit “Lugina e Diellit” ishte nënshkruar në vitin 2015 nga Zyra për Kosovën e Qeverisë së Serbisë, Dioqeza e Rashkës dhe e Prizrenit e Kishës Ortodokse Serbe dhe organi i përkohshëm në Zveçan, që funksionon në kuadër të sistemit serb.

Në krye të këtij organi është Ivan Todosijević, ish-ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal të Qeverisë së Kosovës nga radhët e Listës Serbe, partisë më të madhe serbe në Kosovë.

Vendbanimi është duke u ndërtuar që nga viti 2016.

Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, në një letër dërguar komunës së Zveçanit, e cila e ka shpallur “Qytetar Nderi” më 14 korrik, ka thënë se “gjithçka që bëhet dhe ndërtohet, çdo gur në Luginën e Diellit është themeli ynë për të ardhmen në këto hapësira”.



## Komuna e Malishevës ekzekutoi mjetet për 210 nëna që kanë lindur fëmijë

**MALISHEVË, 16 KORRIK (ER)** - Sipas drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa në komunën e Malishevës, Valon Mazreku, janë ekzekutuar mjetet në vlerë nga 100 euro edhe për 210 nëna të cilat kanë lindur dhe kanë aplikuar për mbështetje

në mjete. Vlera e mjeteve të ekzekutuara është 21 mijë euro. Komuna e Malishevës, bazuar në vendimin e Kuvendit të Komunës, për çdo nënë që lind fëmijë, jep nga 100 euro dhe kjo përkrahje zbatohet që nga muaji shtator i vitit 2018.

Vlen të theksohet se gjatë vitit 2021, përkatësisht në muajin prill, janë përkrahur 228 nëna dhe tani 210, që i bie se gjatë këtij viti deri më tani janë përkrahur 438 nëna apo, shprehur në mjete, janë ekzekutuar gjithsej 43 800 euro.



## Nis në Llap fushata e korrje-shirjeve

**PODUJEVË, 16 KORRIK (ER)** - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka vizituar fshatin Shtedim për ta përcjellë mbarëvajtjen e fushatës së korrje-shirjeve.

Bulliqi u shpreh i kënaqur me dinamikën e zhvillimit të fushatës dhe rendimentet që po realizohen këtë vit. "Falë kushteve të mira klimatike, fushata e korrje-shirjeve po zhvillohet mbarë e mirë, po ashtu kjo ka pasur ndikim që të kemi edhe rendimente të mira të grurit. Për bujqit llapjanë uroj të korra të suksesshme e të bereqetshme me dëshirën që të plotësohen nevojat e të ushqehemi nga produkti i

tokave tona", ka thënë Bulliqi derisa po përcillte fushatën e korrjes-shirjes. Ai u zotua se sektori i bujqësisë përherë do ta ketë vëmendjen e komunës për mbështetje.

Ndërsa Vigan Salihu, drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural i komunës së Podujevës (DBPZHR), ka thënë se në territorin e kësaj komune me drithëra këtë vit janë të mbjellë 5 560 hektarë. Prej këtyre, 4 932 hektarë me grurë, 72 ha me elb, 61 ha thekër dhe tërshërë 495 ha. Këtë vit rendimentet e grurit në territorin e komunës së Podujevës sillen prej 4 500 deri 4 700 kilogramësh për hektar.



## Kastrati viziton fshatin Koretin, hapet rruga e cila ishte problem shumëvjeçar për banorët



**KAMENICË, 16 KORRIK (ER)** - Kryetari i komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, së bashku me zyrтарin komunal, Alban Hashani, kanë vizituar fshatin Koretin, pas zgjidhjes së problemit 50-vjeçar të disa banorëve të këtij fshati. Kastrati ka thënë se është shumë i lumtur që problemet e akumuluar për disa vjet po i zgjidhin një nga një, duke pasur bashkëpunim të ngushtë me komunitetin. "Problemi i kamotshëm mbi 50-vjeçar të disa nga banorët e Koretinit tashmë është i

zgjdhur për kryerjen e obligimeve që kanë, për punimin e tokave në hapësirë prej rreth 300 hektarësh. Një pjesë të rrugës e cila ka qenë pronë private e kemi shpallur interes të përgjithshëm publik, me miratim të Kuvendit Komunal dhe në pajtim të plotë me familjen Hoda, pronare e kësaj parcele. Jam shumë i lumtur që problemet e akumuluar që sa vite po i zgjidhim një nga një, duke pasur bashkëpunim të ngushtë me komunitetin", ka thënë Kastrati.

## Mbi 13 000 gjilanas janë vaksinuar kundër Covidit

**GJILAN, 16 KORRIK (ER)** - Komiteti për Menaxhimin dhe Parandalimin e Përhapjes së Covid-19 në Gjilan, në takimin e mbajtur të premten, udhëhequr nga nënkryetari i komunës, Arbër Ismajli, kanë bërë vlerësimin e gjendjes aktuale dhe duke marrë parasysh që me ardhjen e mërgatës në shtëpitë dhe familjet e tyre, kërkohet vigjilencë dhe kujdes i shtuar për

parandalim të virusit dhe vaksinimi të vazhdojë edhe me numër më të madh. Nënkryetari Ismajli ka bërë me dije se deri tani janë vaksinuar 13 910 gjilanas kundër Covid-19, derisa ka konfirmuar se procesi i vaksinimit po shkon shumë mirë. Ai ka potencuar se të gjithë ata që janë testuar dhe në rezultat e tyre konfirmohet se janë të infektuar me virusin

Covid-19 duhet të qëndrojnë në vetizolim. Gjendja e përgjithshme në bazë të statistikave zyrtare konfirmohet se në këtë komunë janë 6 340 qytetarë të shëruar, 147 qytetarë kanë humbur betejën me Covid-19, 28 raste janë aktive, deri më sot janë testuar gjithsej 21 962 qytetarë dhe të hospitalizuar sot janë vetëm dy qytetarë që po përcillen vazhdimisht nga mjekët.





## IKShPK-ja: Uji në Drenoc të Deçanit është i papijshëm

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 16 KORRIK - "Uji në fshatin Drenoc në komunën e Deçanit është i papijshëm, pasi në ujëmbledhës janë gjetur vlera të shtuara të baktereve koliforme dhe E.coli", ka bërë me dije Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK). Ky institut një ditë më parë ka njoftuar se nga mostrat e ujit, të marra në Deçan më 12 korrik, janë identifikuar disa baktere që "mund të japin indikacion për kontaminim të ujit të pijshëm".

Institucionet shëndetësore në Deçan që nga fundjava e kaluar janë duke u përballur me fluks

pacientësh që raportojnë simptoma të helmimit. Sipas të dhënave nga kjo komunë, 1 392 persona kanë kërkuar ndihmë në Qendrën e Mjekësisë Familjare.

IKShPK-ja ka njoftuar se është duke kryer analiza të vazhdueshme të ujit, ndërsa disa mostra të pacientëve të helmuar është thënë se do të dërgohen për testim jashtë Kosovës.

Në njoftimin për media të lëshuar të premtën, IKShPK-ja ka njoftuar se në mostrat e ujit të ujësjellësit të datës 13 korrik nga rajoni i Deçanit, "janë identifikuar disa baktere jopatogjene" dhe se ato "mund të japin indikacion për kontaminim të ujit të pijshëm". Po ashtu, edhe komuna e Deçanit ka njoftuar

qytetarët që furnizohen me ujë nga ujësjellësi që rrjedh nga rezervari në Drenoc, ku bëjnë pjesë fshatrat Prejlep, Rastavicë, Baballoq, Gramaqel, Dubravë, Shaptej, Jasiq i Ri, Glllogjan, Ratish i Epërm, Ratish i Ulët, Irzniq dhe Prokolluk, të mos e përdorin për pije ujin e këtij ujësjellësi.

Deçani furnizohet me ujë nga ujësjellësi rajonal "Hidrodrini".

"Hidrodrini" furnizon me ujë edhe komunat Pejë, Istog, Klinë dhe Junik.

Në një deklaratë më 13 korrik, "Hidrodrini" ka porositur qytetarët që furnizohen nga ky ujësjellës, që të mos kenë dyshime në cilësinë e ujit.

Kryetari i komunës së Deçanit,



Bashkim Ramosaj, ka thënë se Kompania Rajonale "Hidrodrini" nuk do ta ketë Deçanin më nën menaxhim. "Do të jetë një kompani

komunale e cila do të ketë adresim dhe do të ketë në dispozicion edhe taksat e qytetarëve të Deçanit", ka deklaruar Ramosaj.

## Njëmbëdhjetë raste të reja me Covid në Kosovë



PRISHTINË, 16 KORRIK (ER) - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Kosovë (IKShPK) ka regjistruar të premtën 11 raste të infektimit me Covid-19 pas testimit të 1 366 mostrave.

Gjatë 24 orëve të fundit nuk është regjistruar asnjë viktimë. IKShPK-ja ka njoftuar se më 16 korrik janë shëruar 17 pacientë nga sëmundja Covid-19, ndërsa raste aktive janë 99. Prej 13 marsit 2020, kur janë

regjistruar rastet e para të infektimit, autoritetet shëndetësore në Kosovë kanë regjistruar 107 894 pacientë me këtë virus. Prej këtyre, 2 264 kanë vdekur.

Në Kosovë tashmë ka nisur

programi i vaksinimit masiv kundër koronavirusit.

Në këtë vend ka vaksina të prodhuesve "Pfizer/BioNTech" dhe "AstraZeenca".

Në 24 orët e fundit ndonjërin nga këto vaksina e kanë marrë

11 546 persona.

Numri i personave të vaksinuar me të dyja dozat e vaksinave ka shkuar në 88 961, ndërsa shifra totale e vaksinave të dhëna është 305 991.

## Më 20 korrik dita e parë e Kurban Bajramit



PRISHTINË, 16 KORRIK (ER) - Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës (BIK) ka njoftuar besimtarët dhe opinion e gjerë se dita e parë e festës së Kurban Bajramit është të martën më 20 korrik. Me këtë rast, BIK-u ka bërë me dije se manifestimi qendror për territorin e Kosovës, kushtuar festës së Kurban Bajramit, do të mbahet në Xhaminë e Madhe në Prishtinë. "Namazi i sabahut falet në orën

4:40. Ligjëratën tematike kushtuar festës së Kurban Bajramit do ta mbajë dr. Valon Myrta, anëtar i Kryesisë së BIK në Kosovë, njëherësh kryetar i KBI në Gjakovë. Namazi i Kurban Bajramit falet në orën 05:51, të cilit do t'i prijë kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, ndërsa Hytben - mesazhin e Kurban Bajramit - do ta mbajë myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë. Me rastin e

festës së Kurban Bajramit, ditën e parë, më 20 korrik 2021, Kryesia e BIK-ut, si tradicionalisht, organizon pritje përirimi në selinë e Kryesisë nga ora 9:00-12:00. Kryesia e Bashkësisë Islame e Kosovës të gjithë besimtarëve dhe opinionit të gjerë ua uron festën e Kurban Bajramit, duke e lutur Zotin që të na pranojë lutjet dhe ibadetet tona. Me fat festa e Kurban Bajramit!", ka njoftuar BIK-u.



# Dështon në Kuvend miratimi i marrëveshjes ndërkombëtare

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

**PRISHTINË, 16 KORRIK** - Në mungesë të kuorumit në vendimmarje, Kuvendi i Kosovës ka dështuar ta miratojë Projektligjin për Ratifikimin e Amendamentimit të Marrëveshjes Ndërkombëtare me Bankën Evropiane për Investime për financimin e projektit për rehabilitimin e linjës hekurudhore 10. Përderisa pozita ka kërkuar mbështetjen e deputetëve të Kuvendit të Kosovës për ta miratuar këtë marrëveshje, opozita nuk ka marrë pjesë në votim me arsyetimin se janë injoruar nga partia në pushtet duke mos marrë informata të nevojshme për këto

marrëveshje ndërkombëtare. Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka arsyetuar Projektligjin për Ratifikimin e Amendamentimit të Marrëveshjes Ndërkombëtare me Bankën Evropiane për Investime për financimin e projektit për rehabilitimin e linjës hekurudhore 10. Ai ka thënë se ky projektligj do të financohet 50 për qind grant dhe 50 për qind me kredi nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Banka Evropiane për Investime. Sipas Muratit, amendamentimi i këtij projektligji është më tepër çështje teknike dhe nuk krijon obligime të reja financiare për Kosovën. Përfaqësuesit e partive opozitare

kanë deklaruar se nuk do të marrin pjesë në votim për shkak se nuk janë konsultuar nga pozita për këtë çështje. Deputeti i PDK-së, Bedri Hamza, ka thënë se nuk janë konsultuar asnjëherë nga LV-ja për këtë marrëveshje. Ai ka thënë se pozita ka deklaruar se i ka votat dhe ka përjashtuar në këtë rast opozitën. Deputeti i LV-së, Armend Muja, ka thënë se i vetmi ndryshim substancial në këtë marrëveshje është zgjatja e afatit për implementim. "Nuk ndryshon asgjë në përmbajtje. I vetmi ndryshim substancial është zgjatja e afatit për implementimin e kësaj marrëveshje dhe teknikalitetet në emërtime. Për këtë arsye ne i

rekomandojmë fuqishëm Kuvendit, grupeve parlamentare, që në emër të interesit kombëtar dhe të rëndësisë së veçantë të këtij projekti, ta japin votën për miratim", është shprehur Muja. Shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Arben Gashi, ka thënë se ministri Hekuran Murati e kishte bllokuar këtë marrëveshje në mandatin e kaluar. Gashi ia ka kujtuar LV-së se më herët nuk i kishte votuar marrëveshjet ndërkombëtare. Edhe deputeti i AAK-së, Pal Lekaj, ka thënë se nuk do të marrin pjesë në votim për shkak të arrogancës së pushtetit. "Ndoshta i keni numrat. Ju keni injorancë totale për opozitën dhe mendoj se nuk ia vlen të bisedojmë për këto çështje.

Duhet ta keni parasysh se ndonjëherë edhe 2/3 nuk vlejné nëse nuk kërkon konsensus dhe bashkëpunim me opozitën", ka thënë Lekaj. Ndaj këtyre deklaratave ka reaguar shefa e grupit parlamentar e LV-së, Mimoza Kusari-Lila, e cila ka theksuar se opozita e tanishme i ka humbur zgjedhjet jo për shkak të mosvotimit të marrëveshjeve, por për shkak të kulturës së keqeverisjes. Kundër qëndrimit të partisë së tij ka dalë deputeti i PDK-së, Xhavit Haliti, i cili ka thënë se çështjet që votohen në Kuvend janë në interes të Kosovës dhe duhet të qëndrojnë në sallë dhe të votojnë për, kundër apo të abstenojnë.



## KEDS-i do t'i trajtojë me prioritet kërkesat për lidhje të re nga diaspora



**PRISHTINË, 16 KORRIK (ER)** - Kompania Kosovare për Distribuim të Energjisë Elektrike në Kosovë sh.a. (KEDS) ka vendosur që gjatë verës t'i trajtojë me prioritet kërkesat që vijnë nga diaspora. "Një pjesë e konsiderueshme e tyre blejnë prona rezidenciale në Kosovë ose po i ndërtojnë vetë. Si rrjedhojë, gjatë kësaj stane KEDS-i në vazhdimësi stonon kërkesa për lidhje të reja nga konsumatorët

nga diaspora të cilët kërkojnë që të trajtohen me prioritet për arsye të kohës së shkurtër që qëndrojnë në Kosovë. Në këtë drejtim, KEDS-i ka ndërtuar një sistem të identifikimit të kërkesave për lidhje të re për pjesëtarët e diasporës", është thënë në komunikatën e KEDS-it. Sipas kësaj komunikate, gjatë kërkesës për lidhje të re nga diaspora duhet të merret me vete edhe pasaporta e vendit rezident apo leja e qëndrimit në atë vend, e

cila dëshmon se aplikuesi është nga diaspora. "Më pas kompania do ta shqyrtojë kërkesën në kohën më të shkurtër të mundshme dhe do të procesohet tutje. KEDS-i mbetet kompani e përkushtuar që të jetë sa më afër konsumatorëve. Ndërtimi i partneritetit me konsumatorë dhe ofrimi i shërbimeve sa më kualitative janë prioritetet të kompanisë", theksohet në komunikatën e KEDS-it.

## Ndryshimet për Ligjin për Automjete kalojnë edhe në Komisionin për Legjislacion

Prishtinë, 16 korrik (ER) - Në mbledhjen e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër

Korrupsionit, me 7 vota për ka miratuar raportin me amendamente të Komisionit Funkcional në Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për

Automjete që parasheh heqjen e monopolit për homologimin e automjeteve nga vendet e BE-së. Deputeti i PDK-së, Hajdar Beqa, ka thënë se Ligji për Automjete

ka nevojë për shumë ndryshime. Por, sipas tij, interesi i qytetarëve është që të ndryshohet edhe neni 44 që ka të bëjë me kushtëzimet.







ALBERT CAMUS

# PËRGJEGJËSIA E ARTISTIT

Një i mençur nga Lindja gjithmonë i lutej hyjnisë së tij ta mbronte nga të jetuarit në kohë interesante. Meqenëse ne nuk jemi të mençur si ai, hyjnia jonë nuk na ka mbrojtur sepse jetojmë në kohë interesante. Në çdo rast epoka jonë s'na lë asnjë mundësi që ta shpërfillim. Shkrimtarët e sotëm tashmë e dinë këtë. Nëse flasim, ata menjëherë kritikohen e sulmohen. Nëse qëndrojnë të heshtur nga përlësia, askush s'do të flasë kurrë për asgjë tjetër përveç heshtjes së tyre, për t'i fyer shumë rëndë.

Mes kësaj zhurmaje shurdhuese, shkrimtarët s'mund të shpresojnë më të rrinë mënjanë për t'i bluar në mendje mendimet dhe reflektimet që çmojnë fort. Deri më tani ka qenë deri-diku e mundur të rrih mënjanë nga historia. Kushdo që s'pajtohej me ngjarjet shpesh mund të heshte, ose të fliste për të tjera gjëra. Sot gjithçka ka ndryshuar: vetë heshtja ka marrë kuptim të frikshëm. Koha kur të qëndruarit mënjanë shihej si një zgjedhje, dhe qortohej ose vlerësohej si e tillë, artistët, duam ose jo, u përfshinë. Dhe këtu, fjala u përfshinë më duket shumë më e saktë sesa u angazhuan. Në fakt, nuk është thjesht çështje e angazhimit vullnetar të artistit, por më tepër e shërbimit të detyrueshëm ushtarak. Të gjithë artistët sot kanë hyrë në galerinë e kohës. Ata duhet ta pranojnë faktin edhe nëse e ndiejnë

se anija e tyre qelbet nga era peshk, se ka me të vërtetë shumë mbikëqyrës tiranë dhe, për më tepër, që po del jashtë kursit të veprimit. Jemi në det të hapur. Artistët, si të gjithë të tjerët, duhet të shprehen, pa vdekur, nëse është e mundur - kjo do të thotë, duke vazhduar të jetojnë dhe të krijojnë.

Të them të drejtën, kjo s'është e lehtë dhe unë e kuptoj se si artistët mund t'i marrë malli për jetën e rehatshme të mëparshme. Ndryshimi që ka ndodhur ka qenë mjaft brutal. Sigurisht, në amfiteatrin e historisë gjithmonë ka pasur martirë dhe luanë. Martirët gjenin forcë tek ideja e lavdisë së përjetshme, luanët nga ushqimi shumë i përgjakshëm historik. Por, deri më tani artistët kanë mbetur gjithmonë mënjanë. Kënduan pa ndonjë arsye, për kënaqësinë e tyre ose, në rastet më të mira, për ta nxitur martirin dhe për t'u përpjekur ta shpërqendrojnë luanin nga preja. Tani, përkundrazi, artistët e gjejnë veten të zënë në kurth brenda amfiteatrit. Zërat e tyre, natyrshëm, s'ingëllojnë më njësoj: janë shumë më pak të sigurt.

Është e lehtë të shohësh se çfarë rrezikon të humbasë arti nga një përfshirje kaq e vazhdueshme: më së shumti humbet rehatinë e mëparshme, dhe atë liri hyjnore që jeton dhe merr frymë në veprat e Moxartit. Tani mund ta kuptojmë më mirë atmosferën sflitëse dhe të

paepur të veprave tona të artit, ngjitjet e tërbuara dhe rëniet e papritura. Kësisoj i themi vetes se e kuptojmë arsyen pse ka më shumë gazetarë sesa shkrimtarë, më shumë piktorë amatorë sesa Cézannes dhe pse letërsia për fëmijë dhe misteret e vrasjeve kanë zënë vendin e Luftës dhe paqes të Tolstoit ose të Manastirit të Parmës të Stendalit. Natyrisht, gjithmonë mund t'i kundërvihemi kësaj gjendjeje me vajtime humaniste, për t'u bërë ai që Stepan Trofimovichi dëshpërimisht dëshiron të simbolizonte te Djajtë e Dostojevskit: fyerjen e mishëruar të një njeri. Dhe pikërisht si ai personazh, ne po ashtu mund të përjetojmë periudha dëshpërimi qytetar. Por ai dëshpërim s'do të ndryshonte asgjë në lidhje me atë që vërtet po ndodh.

Për mendimin tim, do të ishte shumë më mirë të bëheshim pjesë e kohës sonë pasi epoka jonë po bërtet me zë të lartë që ta bëjmë këtë, duke pranuar me qetësi që epoka e mjeshtrëve të adhuruar, artistëve me lulëkuqe në xhaketa dhe gjenitë e kolltukëve, ka mbaruar. Të krijosh sot, do të thotë të krijosh në mënyrë të rrezikshme. Çdo botim është një veprim i qëllimshëm dhe ai akt na bën të cenusëm nga pasionet e një shekulli që s'fal asgjë. Dhe kështu, çështja s'është të dimë nëse të veprosh është apo nuk është e dëmshme për artin. Çështja, për

këdo që s'mund të jetojë pa art dhe gjithçka që ai nënkupton është, thjesht, të dijë - duke pasur parasysh kontrollin e rrepta të ideologjive të panumërta (kaq shumë kulte, çfarë vetmie!) - se si mbetet e mundur liria enigmatike e krijimit. Në këtë aspekt, s'mjafton të thuash thjesht që arti kërcënohet nga fuqitë e shtetit. Në fakt, në këtë rast problemi do të ishte i thjeshtë: artisti ose do të luftonte ose do të kapitullonte. Problemi është më i ndërlikuar, më shumë çështje jete dhe vdekje, në çastin kur kuptojmë se beteja po bëhet brenda vetë artistëve. Urrejtja ndaj artit, e cila ka kaq shumë shembuj të mrekullueshëm në shoqërinë tonë, lulëzon kaq mirë sot sepse mbahet gjallë nga vetë artistët. Artistët që na paraprinë kishin dyshime, por ajo tek e cila dyshuan ishte talenti i tyre. Artistët e sotëm dyshojnë nëse arti i tyre është i nevojshëm. Racinei i vitit 1957 do të kërkonte falje sepse kishte shkruar Berenice në vend që të luftonte për Ediktin e Nantes. Ky rivlerësim i artit nga artistët ka shumë arsye, por ne po shqyrtojmë vetëm ato më të rëndësishmet. Në skenarin më të mirë, kjo shpjegohet nga përshtypja që artistët bashkëkohorë mund të kenë se ata po gënjëjnë ose po flasin pa ndonjë arsye nëse s'marrin parasysh fatkeqësitë e historisë. Ajo që karakterizon kohën tonë, është tensioni midis ndjeshmërisë

bashkëkohore dhe ngritjes së masave të varfra. Ne e dimë që ato ekzistojnë, ndërsa më parë ishim të prirë t'i shpërfillim. Dhe nëse jemi të vetëdijshëm për to, s'ndodh ngaqë elitat, elitat artistike apo të tjera, janë bërë më të mira. Jo, le ta kemi të qartë: ndodh ngaqë masat janë bërë më të forta dhe s'do të na lejojnë t'i harrojmë.

Ka edhe arsye të tjera për këtë heqje dorë nga përgjegjësia, disa prej të cilave janë më pak fisnike. Por cilat do që të jenë arsyet, ato kontribuojnë në të njëjtin qëllim: të shkruajmë veprimtarinë e lirë krijuese duke sulmuar thelbin e saj kryesor, i cili është vetëbesimi i artistit krijues. Siç e ka thënë Emersoni në mënyrë kaq madhështore: "Bindja e njeriut ndaj gjenisë së vet është përcaktimi përfundimtar i besimit". Dhe një shkrimtar tjetër amerikan i shekullit 19 ka shtuar: "Për sa kohë që një njeri mbetet besnik ndaj vetvetes, gjithçka është përparësi për të: qeveria, shoqëria, madje edhe dielli, hëna dhe yjet". Një optimizëm i tillë i çuditshëm duket i vdekur sot. Artistët, në shumicën e rasteve, kanë turp për veten dhe privilegjet e tyre nëse kanë ndonjërin prej tyre. Më e rëndësishmja, ata duhet t'i përgjigjen pyetjes që i bëjnë vetes: A është arti një luks mashtrues?

(Marrë nga numri i 11-të i revistës "Akademia". Përktheu: Granit Zela. © "Armagedoni")





INTERVISTË ME POETIN DHE PROFESORIN E LETËRSISË SHQIPE, SALI BASHOTA (2)

# NUK SHKRUAJ NË ÇDO VEND SIÇ SHKRUANTE ALI PODRIMJA

**BISEDOI: BERAT  
ARMAGEDONI**

*Ku dhe kur shkruani?*

Edhe pse Heminguei thoshte se është shumë keq që një shkrimtar të flasë se si shkruan, megjithatë shkrimtarë të njohur kanë shkruar për provën e imagjinatës, për ta kuptuar pjesën më të mahnitshme të frymëzimeve të tyre, më tutje edhe si përvojë krijuese, duke e ditur faktin se një ndër principet më të rëndësishme të njeriut është vetënjohja. Mendoj se poezia është një shkëmbim i njohurive për jetën dhe shkrimin përmes vetënjohjes, ndërsa filozofia e saj është një arsye apo një proces i komunikimit për ta kuptuar jetën njerëzore në

kërkimin e vetvetes.

Shkruaj dhe i shpreh ndjenjat pikërisht nga rezultati i bashkimit të frymëzimeve në një horizont, aty ku rrinë dashuria dhe fantazia, të cilat janë si pikat e ujit në shpirtin e njeriut që i japin fuqi motivimit të papërsëritshëm në jetë dhe në krijimtari.

Borhesi thoshte se “jeta bëhet nga poezia”. Çfarë mrekullie për poetët. Mbase kjo thënie mund t’i përgjigjet edhe krijimtarisë sime dhe, nganjëherë, më duket vetja se jam gjithmonë i ngarkuar me kujtime që banojnë në shpirtin tim, duke pritur rishpërthimin e ndjenjave.

Kur shkruaj nuk pëlqej ndonjë ceremoni të veçantë siç bënin shumë shkrimtarë botërorë. Për shembull, të vishem me rroba të bukura çdo

mëngjes, të pi kafënë më pak qumësht apo të flas vetë me vete se çfarë do të bëj gjatë ditës. T’i lexoj poezitë me zë të lartë apo të përmllohem për kohën e fëmijërisë, kur vështirë i mësoja poezitë përmendësh. Asokohe mendoja se jo secila poezi mund të ketë fjalë të pavdekshme, as ritëm, as figurë, as përjetim, as ndikim...

Poeti mund të jetë ëndërrimtar mjaft i përpiktë kur përpiket të zbulojë gjëra të bukura që i flenë në shpirt, duke i ringjallur kujtimet, për ta ndërtuar pasionin, kënaqësinë, përjetimin jo vetëm për vetveten, por edhe për të tjerët.

Në intervistën time, me titullin *Poezia si teori e dashurisë*, i kam paraqitur mendimet lidhur me pyetjen *ku shkruani?* Me këtë rast po i paraqes edhe disa mendime të

tjera.

Nuk shkruaj në çdo vend siç shkruante Ali Podrimja, apo siç shkruajnë shumë poetë. Mbase e kam krijuar në vetvete një lloj teorie të frymëzimit, me vetë faktin se para se të shkruaj më duket se krijoj të fshehtë për ta sublimuar të bukurën. Në librin tim të zgjedhur me poezi, me titullin *Dhembje e bekuar 333 poezi*, në ballinë i kam përzgjedhur 33 figura që i përdor më së shumti në tërë krijimtarinë time. Ato janë: Zoti, dashuria, bukuria, vendlindja, zjarri, rruzullimi, vetmia, trishtimi, vdekja, ëndrra, gjarpri, përjetësia, parajsja, ferri, purgatori, lulja, nëna, shiu, gjaku, pagjumësia, drita, gjuha, toka, heshtja, dritarja, hija, fjala, pasqyra, guri, gjuha, koha dhe dorëshkrimi.

Jo rrallë mendoj për dyqind

fjalët e Lasgushit për poezinë dhe për mendimin e tij se *poezia nuk është te fjalët, poezia është te poeti*. Zakonisht shkruaj në orët e hershme të mëngjesit. Nuk shkruaj çdo ditë. Ndodh që nuk shkruaj poezi deri në tre-katër muaj. Sikur më mbushet mendja me lloj-lloj idesh, përfytyrimesh, mendimesh, pastaj i vendos vargjet në kompjuter.

Krijimi i poezisë është akt solemn siç do të mund të ishte gjurma e një buzëqeshjeje, ndoshta edhe nga rimarrjet që tashmë i përkasin një tendence estetike që ka të bëjë me magjinë krijuese.

Është shumë interesante. Një ditë seç m’u kujtua buzëqeshja e fundit e Beatrices së Dantes, ditën tjetër udhëtimi poetik i Borhesit nëpër labirintet e bibliotekës, pastaj shumë



romane të bukura me histori dashurie. Shpesh më ka ndodhur të riprodhoj diçka në mënyrën time, në stilin tim, duke iu referuar hollësive dhe situatave, ndoshta që i kam lexuar e gjetur në veprat e ndryshme. Kjo është kujtesa e shkrimit që e ndjek secilin autor, kur dëshiron të zbulojë ide, koncepte, kuptime, përmbajtje të reja, natyrisht për të cilat ishte shkruar edhe më herët.

Konceptin e të menduarit për letërsinë gjithmonë e kam synuar për trajtimin e fenomeneve dhe dukurive njerëzore, për t'i rikthyer në procesin krijues të veprës. Jam përpjekur ta shpjegoj në vetvete shkaku e lindjes së frymëzimeve. Ku qëndron thelbi i tyre? Përse më josh përnjëherë letrarja dhe filozofikja kur shkruaj? Sikur e ndërtoj një raport në ndërdije me këta dy përbërës. Ndoshta kjo bëhet mënyrë e përcaktimit ku përqendrohem për realizimin e një lloj shkrimi, duke e kërkuar besueshmërinë për të dyja. Shpeshherë më ka ndodhur ta braktis atë çfarë kam shkruar, kur pikëpamjet e mia i ka zotëruar një refleksion tjetër, se shkrimi ende nuk është në nivelin që më pëlqen mua. Umberto Eco do të thoshte se invencioni prodhon realitet.

#### Për çfarë ju merr malli?

Sigurisht malli më i veçantë për mua është që të jem sa më gjatë në mjedisin familjar, i rrethuar nga të dashurit e mi. Shumë shkrimtarë kanë thënë se duke shkruar libra bëhen të lumtur. Nuk e di ku qëndron aftësia krijuese e shpirtërore e shkrimtarit për të qenë i lumtur përbrenda atmosferës së fantazisë për t'i zbuluar ndjenjat e tij. Më së shumti më merr malli për dashurinë që ekziston brenda ndjesisë sime. Vullneti i njeriut në çdo situatë qëllimin përfundimtar e ka te lumturia dhe dashuria apo te virtyti i të dyjave bashkë.

Vitet e fundit më së shumti rri në *Symphony* dhe në *Amaro*, dy lokale të bukura në Prishtinë. Secilin njeri shpeshherë e merr malli sidomos për kohën e fëmijërisë dhe për më të dashurit që nuk jetojnë më. Edhe mua më ngjan kjo, edhe pse ndonjëherë më duket se kujtesa është e paprekshme. Gjithnjë mendoj se kujtimet mbijetojnë vetëm në shkrime. Shpesh më merr malli për shiun që m'i lagte flokët në kohën e fëmijërisë. E ndieja një kënaqësi shpirtërore asokohe kur më lagte shiu sepse nëna më thoshte se shiu të rritë e të bën të madh. Sikur shiu me kohë u bë onomatope interesante në poezinë time. Piklat e shiut e kishin muzikalitetin dhe ritmin e vet

kur binin në tokë. Asokohe mendoja se sikur unë isha ndërmjetës midis qiellit dhe tokës. Kjo që një kënaqësi e papërkshuar për mua. Fuqinë e frymëzimit në poezinë time, jo rrallë, e kam ndërlidhur edhe me vjeshtën. Gjithnjë më merr malli për stinën e vjeshtës, sepse shumicën e librave të mi i kam shkruar në vjeshtë. Në fakt, periudha e përfundimit të stinës së verës dhe fillimi i vjeshtës sikur më japin fuqi shpirtërore për të shkruar. Disa herë kam menduar pse më ndodh kjo? Sikur e analizoj ndjenjën e dashurisë për t'i nxjerr poetikisht efektet që i shkakton ajo. Vërtet më ndodh një lloj metamorfoze e çuditshme, ndoshta vetëm për ta përvetësuar atë ndjeshmëri poetike që buron nga shpirti krijues. Prandaj, kjo më mjaftonte për t'i shtresuar gjithë ato dallgë të frymëzimit që e kanë magjinë e vet poetike, stilistike, figurative apo edhe diçka më tepër.

#### Çfarë mund të na thoni për tre librat tuaj me poezi të cilët e përbëjnë fazën e parë të krijimtarisë suaj?

Librin e parë me poezi, me titullin *Albumi i grisur*, e kam botuar në vitin 1986. Thonë libri i parë është si dashuria e parë. Dihet, çdo gjë fillon me lumturinë. Më dukej se libri i parë ishte si një ditar intim të cilit nuk ia gjeja fundin. Synoja ta ndërtoja mendimin dhe stilin tim duke i krahasuar gjërat që i ndieja në shpirt me ato që më shfaqeshin si imazhe në çastin e parë. Jo rrallë më dukej se nuk përputhej ideja me qëllimin. Diçka tjetër ëndërroja, ndërsa diçka tjetër më dilte në letrën e bardhë. Më dukej se gjithnjë nxitoja për ta shfaqur mendimin, prandaj sikur më mungonte disiplina krijuese apo durimi. Më pëlqenin sidomos figura e krahasimit dhe e epitetit, por edhe e kontrastit. Dyshoja se në shpirtin tim që formuar një marrëveshje e fshehtë e kuptimeve dhe figurave për vargun dhe për poezinë në përgjithësi. Ndoshta kjo ma sillte dilemën për saktësinë e mendimeve që i riprodhoja shumë gjatë në mendjen time. Nuk më dilnin siç i paramendoja. A isha unë subjekti apo ishte ai tjetri? Ky ishte shqetësimi i radhës. Përse nuk përputhej ndjeshmëria ime me atë të tjetrit, që do të ishte ndoshta sikur unë! Ndoshta nga këtu fillonte zotërimi i brendshëm i dy gjendjeve: atë që ndieja në shpirt dhe ajo tjetra, imagjinaria, që më shqetësonte dhe që më rrethonte për t'u bërë pjesë e jetës shpirtërore. Natyrisht, kjo ishte më shumë se brengë, sidomos për ndërtimin e figurave poetike, ndonjëherë edhe për temat e

padëshifrueshme kurrë deri në fund, të cilat ishin projektuar në kujtesën time, pikërisht nga magjepsja e frymëzimeve.

Me librin e dytë me poezi *Zogu me profil vjeshte* (1989), asokohe kam synuar t'i projektoj idetë e mia përbrenda një teorie krijuese. Fillonte të më shqetësonte më shumë vetëdija për shkrimin, për idetë dhe për temat. A mund të zbuloja më tutje vetëm figura të bukura, të qëlluara dhe domethënëse, për ta shqiptuar procesin e interpretimit të fenomeneve dhe dukurive të jetës. Përse zogu, gjarpri, qyqja, korbi, vjeshta, heshtja, vetmia, dashuria, dhimbja, fati etj., bëheshin figura të bukura dhe të dhimbshme në të njëjtën kohë, përmes të cilave dëshiroja t'i emërtoja gjërat apo dukuritë që më shqetësonin. Synoja ta zbuloja esencën e ëndrrave të mia rinore të cilat gjithmonë e kishin një përmallim të papërkshuar apo të pathënë deri në fund, herën tjetër edhe një revoltë me domethënie të caktuar poetike, të ndërlidhur me temat e aktualitetit, sidomos poezitë që ndërlidheshin me toponiminë, me emërtimet e vendbanimeve, meqë në atë periudhë bëheshin përpjekje për ndryshimin e emërtimeve me përmbajtje shqiptare. Po kështu, libri im i dytë me poezi iu referohet miteve apo strukturave të ndryshme mitologjike, por edhe legjendave dhe baladave. Rozafati, Aloidët, Boa, Troja, Lebetitë, Zogjtë e Stimpalit, Drimona, Lynkesta, Sytë e Argusit, Aka Larenca etj. Në këtë mënyrë, figura, tema, ide, motive të ndryshme, të rimarra në një kontekst të caktuar poetik, vihen në një sprovë të re ligjërimore.

Libri im i tretë me poezi, *Plagomë* (1994), i shkruar në rrethana të caktuar sociale dhe politike, gjithsesi e projekton një dhimbje tjetër njerëzore dhe kombëtare, të ndërlidhur me periudhën kur regjimi i atëhershëm serb ushtronte dhunë të vazhdueshme mbi shqiptarët, në edukim, kulturë, si dhe në shumë fusha të tjera të jetës. Shumë poezi të këtij libri kanë refleksion dramatik në të shqiptuarit e temave të aktualitetit. Gjithnjë synoja një pavarësi estetike, për t'i shpjeguar përmes poezisë fenomenet dhe dukuritë e ndërlidhura me kulturën, gjuhën, identitetin. Në të gjitha variantet e shkrimit liria ishte tema kryesore. Pra, kuptimi i lirisë ishte thelbi i frymëzimit poetik. Përmes *Plagomës* synoja ta bëja kapërcimin apo tejkalimin në një ligjërim të ri poetik, të cilin nuk e kisha aq shumë të pranishëm në dy librat e mi të parë me poezi. Ky parim imi

krijues kishte të bënte me dominimin e figurës, me funksionalizimin e imazhit simbolik, por edhe me paraqitjen dhe zbërthimin e absurdit. Mendoj se me librin tim të tretë me poezi fillon projekti im krijues për funksionalizimin e sistemit poetik në poezinë time. Me kohë e fitova bindjen se ishte libri im përcaktues për të vazhduar më tutje me poezinë, me projektimin e ideve dhe të koncepteve krijuese, për t'ia dëshmuar vetvetes se po nisem në këtë rrugë për ta provuar hyrjen në botën e letërsisë.

#### Si i keni shkruar librat tuaj me ese dhe studime letrare?

Në të vërtetë, fillimisht kam shkruar dhe botuar shumë shkrime kritike, kryesisht recensione, ese dhe studime, në gazeta dhe revista letrare të ndryshme në Kosovë, por më vonë edhe në Shqipëri. Ky që një motivim i jashtëzakonshëm për të vazhduar me kritikën letrare.

Vlerësimi i veprave letrare në vitet tetëdhjetë e nëntëdhjetë të shekullit të kaluar ishte privilegj për kritikun letrar dhe për studiuesin e letërsisë. Më tutje kam vazhduar botimet e veprave me ese dhe studime letrare, siç janë: *Shqipshkrimi kritik* (1997), *Kuteli poet, prozator, kritik* (1999), pastaj të veprave të tjera, *Domethënia e ideve letrare* (2001), *Proza e filleve të modernitetit* (2006), *Studime letrare* (2008), *Enigma e shkrimit* (2018) dhe *Esenca e ligjërimit letrar* (2020).

Në librin me ese dhe studime letrare *Shqipshkrimi kritik* (1997) kam trajtuar tema dhe probleme që kanë të bëjnë me letërsinë moderne dhe me letërsinë e sotme shqipe. Kam trajtuar fenomene të ndryshme letrare dhe estetike, duke provuar të vë komunikimin e qartë me përbërësit kryesorë të tekstit, me një përqendrim të veçantë të kodit tematik dhe të kodit ligjërimor. Ndërkaq, në studimin monografik *Kuteli, prozator, poet, kritik* (vepër që është nderuar me çmimin më të lartë letrar në Kosovë *Pjetër Bogdani* si libër i vitit 1999), përmes qasjes historiko-letrare dhe teorike e kam shqyrtuar veprën e Mitrush Kutelit.

Me veprën tjetër me ese dhe studime letrare, *Domethënia e ideve letrare*, jam përpjekur të vë një dialog kritik me idetë e mëdha nacionale në vitet '20 dhe '30 të shekullit XX, por kam bërë kërkime edhe për autorë të periudhave të ndryshme letrare. Në këtë vepër studimore jam marrë me veprat e autorëve, pothuajse të të gjitha periudhave letrare.

Më tutje, interesimet e mia në fushën e kritikës letrare i kam

vazhduar me veprën studimore *Proza e filleve të modernitetit* (2006), në të cilën trajtohet proza e autorëve emblematicë të letërsisë shqipe: Faik Konica, Ernest Koliqi, Mitrush Kuteli dhe Migjeni. Përqendrimi im është mbështetur kryesisht në trajtimin tematik të veprës së këtyre autorëve, me një analizë letrare, interpretim dhe vlerësim kritik në tri rrafshë kryesore: ngjarja, personazhi dhe rrëfimi, ku pikë referimi bëhet vlera letrare dhe receptimi kritik i filleve të prozës moderne shqipe, kuptohet me autorët kryesorë të saj.

Vepra ime e radhës në fushën e studimeve letrare është *Enigma e shkrimit* (2018), e cila përbëhet nga ese, trajtesa dhe studime të shkruara këtu e njëzet vjet më parë. Në këtë vepër janë studiuar veprat e disa autorëve dhe çështje dhe probleme letrare të diskutueshme, modele krijuese, koncepte mbi letërsinë, duke filluar nga periudha e romantizmit shqiptar e deri te letërsia e sotme shqipe.

Në radhë të parë, poezia, proza, kritika, të shkruara e të botuara nëpër faza dhe periudha të ndryshme të zhvillimit të letërsisë shqipe, janë bërë objekt i interpretimit dhe vlerësimit, me qëllim të njohjes, studimit dhe funksionalizimit të tyre në raport me treguesit e komunikimit letrar. Në këtë libër është bërë trajtimi i temave dhe fenomeneve letrare përmes kriterit vlerësues dhe kriterit estetik, para së gjithash, për të evidentuar dhe konceptuar veçori të reja kuptimore midis krijimit letrar dhe mendimit kritik. Pra, këtu janë trajtuar edhe çështje dhe fenomene aktuale të letërsisë shqipe, duke problematizuar diskursin e saj brenda pikëpyetjeve e këndvështrimeve, por edhe debateve që kanë për qëllim kryesor nxitjen e dialogut për sugjerime dhe propozime për leximin dhe receptimin e letërsisë. Gjithashtu, në veprën *Esenca e ligjërimit letrar* (2020) kam trajtuar vepra të autorëve të letërsisë shqipe, por edhe të letërsisë botërore.

Shumica e veprave të autorëve të lartpërmendur më pëlqejnë, madje disa prej tyre vazhdoj t'i kem edhe shkrimtarë të pëlqyer. Mendoj se kjo është shumë e rëndësishme për një lexues, sidomos për shijen e tij, që t'i ketë shkrimtarët e vet të pëlqyer, por edhe t'i njohë premisat kryesore të letërsisë që ndërlidhen me veprat e tyre.

(Marrë nga numri i 11-të i revistës "Akademia". Vijon në numrat e ardhshëm të gazetës. © "Armagedoni").





**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Batatina: Llapi u eliminua me kokën lart

Një fitore dhe një barazim në dy ndeshjet e para në garat ndërkombëtare është bilanci i skuadrës së Llapit. Pavarësisht prej eliminimit nga Shkupi, trajneri Tahir Batatina e ka vlerësuar të suksesshëm pjesëmarrjen në Europa Conference League. “Ne u eliminuam nga gara e Konferencë së Ligës, por me kokën lart. Të gjithë së bashku, kryesi, staf, lojtarë, edhe ‘Legjendat’, edhe pse nuk u kualifikuam, luftuam dhe bëmë paraqitje dinjitoze dhe premtoj se në vitet në vijim do të jemi ende më të kompletuar dhe me përvojë më të lartë”, ka thënë Batatina

**EPOKA ERE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 16 KORRIK** - Trajneri i Llapit, Tahir Batatina, është shprehur i kënaqur me paraqitjen e skuadrës së tij në ndeshjet e garave evropiane, anë pse skuadra llapjane u eliminua nga Europa Conference League pasi humbi nga Shkupi me rezultat të përgjithshëm 3-1. Llapi në ndeshjen e parë pësoi humbje në Shkup me rezultat 2-0, kurse të enjten në mbrëmje në ndeshjen kthyesë që u zhvillua në stadiumin “Fadil Vokrri” luajti baras 1-1. “Ne u eliminuam nga gara e Konferencë së Ligës, por me

kokën lart. Të gjithë së bashku, kryesi, staf, lojtarë, edhe ‘Legjendat’, edhe pse nuk u kualifikuam, luftuam dhe bëmë paraqitje dinjitoze dhe premtoj se në vitet në vijim do të jemi ende më të kompletuar dhe me përvojë më të lartë. Jam i lumtur që së bashku bëmë historinë pas 89 vjetëve klub, u stolisëm me Kupën e Kosovës dhe për herë të parë u regjistruam në protokollin e futbollit evropian”, ka thënë fillimisht Batatina. Trajneri llapjan është shprehur i kënaqur me paraqitjen e futbollistëve të Llapit. Ai ka premtuar se kjo skuadër në çdo vit do të luftojë për pjesëmarrje në garat evropiane. “I përgëzoj lojtarët apo, thënë ndryshe,

luanët e KF ‘Llapi’ për luftën e pakompromis në fushë dhe paraqitjen shumë dinjitoze. Do t’ju premtoj se KF ‘Llapi’ prapë do të jetë skuadër që do ta kërkojë Evropën për çdo vit dhe do të jemi skuadër shumë solide në vazhdimësi. Faleminderit për të gjithë që më mbështetën dhe më qëndruan afër gjatë kohës sa ishim në organizimin e ndeshjeve të Evropës! Jam i lumtur edhe për tifozët që u rikthyen në tribuna. Kjo ishte një e arritur e madhe falë organizimit të mirë të klubit dhe stafit që pas një kohe të gjatë ata të jenë të pranishëm në ndeshje. Vazhdojmë të bashkuar edhe më të fortë se kurrë drejt realizimit të synimeve të



skuadrës së KF ‘Llapi’”, ka shtuar Batatina.

### Një prej vëllezërve Batatina largohet nga KF Llapi

Amrush Batatina nuk do të jetë më nënkryetar i KF Llapi pasi ka vendosur të japë dorëheqje nga kjo pozitë. Ai ka thënë se këtë vendim e mori për faktin se

është shumë i angazhuar me biznes në Gjermani. “Për shkak të angazhimeve të mia me biznesin tim në Gjermani, më nuk do të jem pjesë e klubit. Kërkoj falje publike nga të gjithë adhuruesit e Llapit, në veçanti nga ‘Legjendat’, nëse i kemi lënduar me ndonjë koment të rastit në rrjetet sociale, por do të jem një tifoz i flaktë i klubit të zemrës”, ka thënë Amrush Batatina.

## Jahjaga, basketbollistëve: Ju jeni ambasadorët më të mira të vendit

**PRISHTINË, 16 KORRIK** - Kosova A për herë të parë do të garojë në arenën ndërkombëtare. Vashat e Kosovës po përgatiten për të qenë sa më të gatshme për Kampionatin Evropian për Shtete të Vogla, që zhvillohet nga 20 deri më 25 korrik në Qipro. Kjo shënon edhe debutimin e vashave “dardane” në garat evropiane. Basketbollistët e Kosovës i ka vizituar ish-presidentja e Republikës së Kosovës, Atifete Jahjaga. “Ndihem e lumtur që jam në mesin tuaj. Me diçka që jam krenuar gjithmonë si presidente dhe pas përfundimit të mandatit është se sportistët kanë qenë



ambasadorët më të mirë të vendit në arenën ndërkombëtare. Ata kudo që kanë shkuar, kanë përfaqësuar

vendin në mënyrën më të mirë të mundshme. Linda (Shala) më tha se ju për herë të parë do të merrni pjesë në një garë ndërkombëtare

dhe kjo është një fitore në vete, pa marrë parasysh rezultatet në fushë. Ju jeni fitimtare. Nga zemra ju dëshiroj fat dhe suksese. Do të jem një lobuese e fuqishme e juaja pa marrë parasysh kudo që jeni”, është shprehur Jahjaga para zyrtarëve të lartë të FBK-së, stafit dhe lojtareve të Kosovës A. Nënkrjetarja e FBK-së, Linda Shala, ishte shumë e lumtur që ish-presidentja e Kosovës mbajti një fjalim shumë frymëzues. “Ne kemi pasur nderin që kemi pasur presidenten e parë grua në Ballkan. Presidentja, edhe pse ka përfunduar mandatin, ka përkrahur fuqishëm rininë dhe gratë në të gjitha sferat e jetës. Ajo

na ka nderuar me praninë këtu. Rrugëtimi i saj gjatë jetës ka bërë që ajo të jetë presidente e Kosovës me punë dhe përkushtim. Ky është edhe një frymëzim për ju”, ka thënë Shala. Edhe sekretarja e përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku dhe anëtarja e Bordit të FBK-së, Teuta Abdullahu, ishin shumë të lumtura me vizitën e ish-presidentes së Kosovës, e cila është inspiruese për gratë dhe një shembull se me punë mund të arrish gjëra të mëdha në jetë. Në fund, basketbollistja e Kosovës, Valbona Bytyqi, i ka dhuruar një fanellë të Kosovës ish-presidentes Atifete Jahjaga.


## Majlinda dhe Akili bartin flamurin e Kosovës në ceremoninë hapëse të Lojërave Olimpikë

**PRISHTINË, 16 KORRIK** - Kampionat Olimpike në Xhudo, Majlinda Kelmendi dhe kampioni i Evropës 2021 në xhudo, Akil Gjakova, do ta bartin flamurin e Kosovës në ceremoninë hapëse të Lojërave

Olimpikë “Tokio 2020”. Për shkak të barazisë gjinore, Komiteti Olimpik Ndërkombëtar ka vendosur që në ceremoninë hapëse të LO Tokio 2020, bajraktarë të jenë dy sportistë të gjinive të

ndryshme. Në ceremoninë mbyllëse, bajraktar do të jetë mundësi Egzon Shala. Kelmendi kishte bartur flamurin edhe në ceremoninë hapëse të Lojërave Olimpikë “Rio 2016”. Ekipi olimpik i

Kosovës përbëhet prej 11 sportistëve. Ceremonia hapëse bëhet më 23 korrik në Stadiumin Olimpik të Tokios, me fillim prej orës 13:00 me kohën tonë lokale dhe në 20:00 me kohën lokale të Japonisë.





## Mehmedi pensionohet nga Kombëtarja e Zvicrës

**CYRIH, 16 KORRIK** - Sulmuesi shqiptar Admir Mehmedi është pensionuar nga përfaqësuesja e Zvicrës. Futbollisti nga Maqedonia e Veriut, i cili është pjesë e Wolfsburgut, ka thënë se ndihet krenar që ka veshur fanellën e helvetikëve, por që ndien se është momenti i përshtatshëm për t'u larguar

Mehmedi ka veçuar dy ndeshje që s'do t'i harrojë kurrë më Zvicrën. Të parën nga viti 2011 në barazimin 2-2 me Anglinë dhe këtë të fundit ndaj Francës ku ai ka realizuar njërin nga penalltitë që i sollën kualifikimin historik Zvicrës. "Këtë fanellë e kam veshur me krenari dhe nder. Unë jam mirënjohës për çdo ditë të

vetme në karrierën time të ekipit kombëtar. Dorëheqja është gjithçka, por e lehtë për mua. Megjithatë, kohët e fundit dëmtimet e ndryshme më kishin ngadalësuar. Kështu që vendosa të përqendrohem në klubin tim VfL Wolfsburg në të ardhmen. Përveç kësaj, unë do të jem në gjendje të kaloj më shumë kohë

me familjen time", ka shkruar Mehmedi. "Në lidhje me ekipin kombëtar të Zvicrës, falënderimet e mia të veçanta shkojnë për trajnerin Ottmar Hitzfeld, i cili bëri të mundur debutimin tim. Falënderoj edhe Vlado Petkoviç, të gjithë shokët e ekipit dhe anëtarët e stafit, tifozët dhe miqtë e panumërt dhe sigurisht familjen



time. Ata të gjithë besuan në mua dhe gjithmonë më mbështetën" ka shtuar Mehmedi.

## Rashica: Fëmijët në Kosovë tash bartin fanella me emrat tanë

**NORWICH, 16 KORRIK** - Repreruesi i Kosovës në futboll, Milot Rashica, gjatë paraqitjes në skuadrën e Norwich Cityt në Premierligë, e ka përmendur Kosovën. Rashica, i cili ka qenë pjesë e Werder Bremenit në Gjermani, ka thënë se tash fëmijët bartin fanellat me emrat e lojtarëve të Kosovës dhe jo sikurse në të kaluarën kur bartin emrat e lojtarëve të tjerë. "Ne shikonim ekipet e tjera kombëtare dhe lojtarët e tjerë, por tani mund të shikosh fëmijët në Kosovë që bartin emrat tanë në fanellat e tyre. Kur ne luajmë, askush nuk punon atje. Të gjithë duan të shkojnë në stadium ose diku për ta parë ndeshjen. Kjo na bënë neve shumë të lumtur dhe krenarë", ka thënë Rashica.

Më pas ish-lojtari i Vushtrisë ka folur edhe për karrierën e tij nga futbollit i Kosovës e deri në atë të Anglisë. "Është një histori e madhe në Kosovë. Ata janë shumë të



ngazëllyer. Edhe në Mbretërinë e Bashkuar kam pasur një mikpritje të ngrohtë nga shumë njerëz kosovarë dhe shqiptarë në Norwich dhe Londër. Mendoj se udhëtimi im është pak më ndryshe, sepse unë fillova në Kosovë dhe më pas nga Liga e Kosovës u transferova në Holandë dhe më pas në Gjermani. Por gjithçka që kam pasur gjatë rrugës dhe gjithçka që ka ndodhur

në të kaluarën thjesht më bënë më të fortë dhe unë jam shumë i lumtur dhe shumë krenar për vendin tonë dhe për të gjithë lojtarët që ia dolën si unë. Kjo është ajo që na jep neve mentalitetin e fortë të punës dhe të jemi të fortë mendërisht. Kjo është një gjë e veçantë për ne sepse nuk harrojmë kurrë prej nga vijmë. Ne çdoherë ia kujtojmë këtë vetes", ka shtuar Rashica.

## Era Shatri: Besojmë në paraqitje të mira

**PRISHTINË, 16 KORRIK** - Basketbollistët e Kosovës A janë gati për debutim në arenën ndërkombëtare. Kjo është hera e parë që Përfaqësuesja A e femrave do të marrë pjesë në një garë evropiane. Vashat e Kosovës do të marrin pjesë në Kampionatin Evropian për Shtete të Vogla që do të mbahet nga 20 deri më 25 korrik në Qipro.

Basketbollistja Era Shatri ka folur për përgatitjet deri më tani. "Kanë shkuar shumë mirë dhe po përgatitemi maksimalisht që të jemi sa më të gatshme për garat ndërkombëtare. Kjo është hera e parë që luajmë në arenën evropiane. E dimë rëndësinë dhe për këtë nuk ka munguar angazhimi në stërvitje", është shprehur Shatri për faqen zyrtare të FBK-së. Kjo është hera e parë që Kosova A do të luajë në garat zyrtare ndërkombëtare. "Kjo është nder për ne. Të gjitha vashat janë



të motivuara që do të luajnë për Kosovën, sepse e dimë që më herët këtë mundësi nuk e kanë lojtarët e tjera, andaj ne do të japim më të mirën tonë në ndeshjet ndaj Qipros dhe Luksemburgut. Shpresojmë në

paraqitje dhe rezultate të mira", ka shtuar Shatri. Vashat e Kosovës janë në grup me Qipron dhe Luksemburgun dhe synimi është për paraqitje pozitive, pasi kjo është hera e parë që garojnë në arenën ndërkombëtare.

### SHKURT

#### Khaka do t'i bashkohet Romës

Pas një vere të gjatë, duket se Granit Xhaka do të përfundojë aty ku është përfolur më së shumti gjatë "Euro 2020", në Romë. Sipas "forzaroma.info", klubet tashmë kanë arritur marrëveshje dhe pritet vetëm konfirmimi zyrtar. Arsenali kërkonte 20 milionë euro, por marrëveshja raportohet të jetë arritur për 15 milionë euro plus 2.5 milionë bonuse. Xhaka nga ana tjetër do të nënshkruajë kontratë katërvjeçare dhe do të fitojë 2.5 milionë euro në sezon te Roma.

#### Cadizi interesohet për Manajn

Rei Manaj mund të jetë shqiptari i tretë që do të luajë këtë sezon në La Liga, pas Keidi Bares dhe Ivan Balliut. Së fundmi, gazetari spanjoll Ignacio de la Varga ka bërë me dije se skuadra e Cadizit ka kërkuar informacione nga Barcelona B për shërbimet e sulmuesit të Kombëtares Shqiptare. Rei Manaj shkëlqeu sezonin e shkuar me 12 gola në kampionat dhe dy në fazën "play-off" me skuadrën e dytë katalanase, mirëpo duket se e ardhmja e tij shihet larg skuadrës katalanase. Cadizi është ngjitur këtë sezon në elitën e futbollit spanjoll dhe kërkon që të përforcohet, duke e parë sulmuesin shqiptar si alternativë cilësore për repartin e avancuar. Deri më tani në Spanjë për Manajn janë interesuar skuadra të ligave më të ulëta, ndaj shihet me interes interesimi i Kadizit që 24-vjeçari të mund të tregojë cilësitë e tij mes më të mirëve.

#### Basketbollistja australiane heq dorë nga Lojërat Olimpike

Frika dhe tmerri nga karantina, ku duhet të qëndrojnë e mbyllur brenda Fshatit Olimpik, pa takuar njeri dhe vetëm të shkojnë për stërvitje e ndeshje, ka bërë që basketbollistja australiane Liz Cabbage të heqë dorë nga Olimpiada. Ajo është një nga lojtarët lidere të Australisë, fituese e medaljes së bronzit në "Londër 2012" dhe asaj të argjendit në Botërorin e vitit 2018. "Nuk është sekret që në të shkuarën kam luftuar për shëndetin tim mendor dhe sot më shqetëson fakti se do të shkoj në një event ku do të qëndroj e mbyllur. Pa familje, pa miq, pa tifozë. Për mua, kjo situatë është një terror. Kohët e fundit kam pasur ankthe, nuk kam fjetur dhe nuk kam ngrënë. Nuk dua të marr mjekime për t'i kontrolluar ankthet e mia", ka thënë basketbollistja 30-vjeçare.

#### Unitedi, afër transferimit të Varanes dhe Trippierit

Manchester United është shumë pranë një transferimi të dyfishtë në merkaton e verës. Pas Sanchos nga Borussia Dortmundi, tashmë mund të afrohen Raphael Varane dhe Kieran Trippier. Solskjaer ka identifikuar mbrojtjen si repartin më të dobët teksa janë në kërkim të Varanes, që shihet si partneri ideal për Maguire. Heroi i Anglisë në "Euro 2020", Trippier, pritet të bashkohet nga Atletico Madridi, teksa dyshja pritet t'u kushtojë rreth 75 milionë euro. Tek Atletico Madrid pritet të shkojë Lingard, i cili duket se nuk bën pjesë në planet e Solskjaerit, por për të duhet fituar konkurrenca me West Hamin.

## Nëse dështon transferimi i Mbappes, Reali e ka në plan Salahin

Në Madrid vijojnë të jenë të fiksuar pas idesë për të veshur me të bardha Kylian Mbappe. Sulmuesi francez ka qenë dhe mbetet prioriteti kryesor,

njëkohësisht edhe transferimi më i ndërlikuar pasi bëhet fjalë për një operacion me një kosto shumë të madhe. Nëse për një arsye apo për një tjetër

transferimi i Mbappes dështon sërish të kryhet këtë verë, drejtuesit e Real Madridit kanë gati një plan B. Sipas mediave spanjolle, Carlo Ancelotti i ka

sugjeruar presidentit Perezit emrin e Mohammed Salah. Në fakt, egjiptiani nuk është një emër i ri në listën e Perezit. Edhe më herët presidenti i Real

Madridit ka shprehur dëshirën për ta pasur në skuadër. Salah nuk e ka më atë lidhje të pathyeshme me Liverpoolin dhe me vetë trajnerin Jurgen Klopp.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACINË  
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR  
AGJENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE  
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 810/1  
Dt: 16.07.2021

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 8, Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Neni 13 dhe 34, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

## KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira në Qendra e Kompetencës në Malishevë për vitin  
shkollor 2021/2022

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i lirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës	Malishevë	Një (1) mësimdhënës/e për profilin Dizajn i tekstit dhe veshjeve (20 orë mësimore); Një (1) mësimdhënës/e për profilin Instalues i ujësjetillës e kanalizim dhe ngrohje e klimatizim, (15 orë mësimore);	Vend i lirë  Vend i lirë

### Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillt me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

### Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet për gatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën trysni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;

### Procedurat e konkurrimit:

Afati i konkurrimit është 15 ditë pas shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës në Malishevë.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.

Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftoheshin në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania Premium Quality, Sh.p.k. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

## DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Ndërtimin e kompleksit të villave dhe restorantit P+1 në Barainë, Podujevë Njoftohet publiku i interesuar se më datën 09.08.2021 në ora 11:00 në lokalitetin Barainë, Komuna e Podujevës” ta organizon në restorantin “Mileniumi i Ri” në Oralln, do të organizohet debat publik nga Kompania Premium Quality, Sh.p.k. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Ndërtimin e kompleksit të villave dhe restorantit P+1 në Barainë, Podujevë

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/85688557678?pwd=Sm9ySmDYNIzHV2tXbk9vNU5xSUtPZz09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë Premium Quality, Sh.p.k. Prishtinë për Ndërtimin e kompleksit të villave dhe restorantit P+1 në Barainë, Podujevë

[https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet\\_dhe\\_publicimet/279/publicimet](https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet)

### Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Idriz Xhemal Fejzullahi, shpall të pavlefshme diplomën e Universitetit të Prishtinës, Fakulteti i Edukimit Gjilan drejtimi Fizik-Kimi.

► Merita Berisha shpall të humbur Licencën e punës të lëshuar nga MASH-ti.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen “Mati 1” Rr. “Muharrem Fejza”, banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen “Mati 1” rruga “Muharrem Fejza” Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen “Mati 1” përball “Super Vivës”, me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër “Bill Clintonit”, kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra “Qerimi2”, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

